



## **INSTITUCIONI I OMBUDSPERSONIT në KOSOVË**

### **RAPORTI SPECIAL Nr. 3**

#### **Mbi**

**Pajtueshmërinë e privimit të lirisë sipas "Urdhëresave Ekzekutive"  
me standardet e njohura ndërkombëtare**

#### **adresuar**

**z. Hans Haekkerup  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara**

Ombudspersoni për Kosovë, në pajtim me nenin 1.1 dhe 4.1 të Rregullorës së UNMIK-ut nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe të Rregullës 22, paragrafi 3 dhe 4 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit, më 29 qershor 2001:

i ka prezantuar raportin në vijim z. Hans Haekkerup, Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, sipas këtyre dispozitave:

## **BAZAT PËR RAPORTIN SPECIAL**

1. Ky Raport Special mbështetet pjesërisht në kërkesat e parashtruara Ombudspersonit nga individët të cilët janë paraburgosur sipas Urdhëresave Ekzekutive të lëshuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (në këtë dokument i referuar si PSSP) dhe pjesërisht në burimet e tjera informative. (Në tërë këtë Raport Special, termi Urdhëresa Ekzekutive ka për qëllim të përfshijë llojet e tjera të udhëzimeve, vendimeve, dekreteve, ose veprimeve tjera të ngjajshme të ndërmarra nga PSSP-ja).

### **PRAPAVIJA**

2. Një numër i individëve të cilët aktualisht ose më parë janë paraburgosur në Kosovë sipas Urdhëresave Ekzekutive të lëshuara nga Përfaqësuesi Special aktual ose i mëparshëm i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara i janë drejtuar organizatave joqeveritare, Organizatës për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë dhe Ombudspersonit për të u ankuar për legjitimitetin e privimit e lirisë së tyre (në këtë dokument e referuar si paraburgim). Këta individë janë ankuar, *inter alia*, për mungesën e bazës ligjore për paraburgimin e tyre, për dështimin e çfarëdo autoriteti qeveritar t'i informojë ata plotësisht për arsyet e paraburgimit të tyre, për mungesën e mekanizmave procedurale nëpërmjet të cilëve ata në mënyrë efektive do të mundnin të sfidonin vazhdimin e paraburgimit të tyre, për mungesën e kompensimit për paraburgim të paligjshëm, si dhe për çështje të ngjashme.

### **HEQJA DORË**

3. Asgjë nga përmbajtja e këtij Raporti Special nuk duhet kuptuar si heqje dorë të Ombudspersonit nga e drejta për të hetuar ankesat e individëve që pohojnë shkeljen e të drejtave të njeriut apo keqpërdorimin e pushtetit lidhur me çështjet e privimit të lirisë. Ombudspersoni rezervon të gjitha të drejtat të ushtrrojë jurisdiksionin e tij ndaj këtyre çështjeve ose çfardo çështje tjetër të lidhur me to.

### **QËLLIMI I RAPORTIT**

4. Përqëndrimi kryesor i këtij Raporti Special është nëse praktika e privimit të personave nga liria në bazë të urdhëresave të lëshuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm është apo nuk është në pajtim me standardet relevante ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të themeluara me nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

### **INSTRUMENTET RELEVANTE**

5. Neni 11 i Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999) (10 qershor 1999) (prej këtu S/RES/1244) (1999) në pjesën përkatëse thotë, "Këshilli i Sigurimit ...vendos që përgjegjësia kryesore e prezencës ndërkombëtare civile do të përfshijë....(j) mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut...'

6. Neni 1 i Rregullorës së UNMIK-ut nr. 1999/1 mbi autoritetin e Administratës së Përkohëshme Civile në Kosovë ( 25 korrik 1999), në pjesën përkatëse thotë:

1. I gjithë autoritetet legjislativ dhe ekzekutiv në Kosovë, përfshirë edhe administratën e judikaturës, i ngarkohet UNMIK-ut dhe ushtrohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

7. Neni 5 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut (4 nëntor 1950) (prej këtu Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ose Konventa) në pjesën përkatëse thotë:

1. Çdo person ka të drejtë në liri dhe siguri. Askujt nuk duhet të i privohet liria përveç në rastet vijuese dhe në pajtim me procedurat e parapara me ligj:

(a) paraburgimi i ligjshëm i personit pas dënimit nga gjykata kompetente;

(b) arrestimi ose paraburgimi i ligjshëm i personit për mospajtueshmërinë me urdhër të ligjshëm të gjykatës ose me qëllim që të sigurohet përmbushja e çfarëdo obligimi të paraparë me ligj;

(c) arrestimi ose paraburgimi i personit i bërë me qëllim që ai person të sillet para autoriteteve kompetente ligjore me dyshim të arsyeshëm se ka kryer një vepër penale ose kur në mënyrë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm parandalimi i atij personi për ta kryer ndonjë veprë penale ose parandalimi i arratisjes pasi ta ketë kryer atë;

(d) paraburgimi i një të mituri me urdhër të ligjshëm me qëllim të mbikqyrjes së tij edukative ose paraburgimi i tij i ligjshëm me qëllim që ai të sillet para autoriteteve kompetente ligjore;

(e) paraburgimi i ligjshëm i personave për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive, të personave me mendje jo të shëndoshë, personave nën ndikim të alkoolit, përdoruesve të drogës ose endacakëve;

(f) arrestimi ose paraburgimi i ligjshëm i personit që të parandalohet hyrja e paautorizuar në shtet ose i personit kundër të cilit ndërmerret ky veprim për shkak të deportimit ose ekstradimit.

2. Çdo i arrestuar duhet të informohet menjëherë, në gjuhën të cilën ai e kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe për akuzën kundër tij.

3. Çdo i arrestuar ose i paraburgosur në pajtim me dispozitat e paragrafit 1.c të këtij neni, do të sillet me kohë para gjykatësit ose para zyrtarëve të tjerë të autorizuar me ligj që të ushtrojnë fuqinë ligjore dhe do të ketë të drejtë për proces gjyqësor mbrenda një kohe të arsyeshme ose të lirohet në pritje të procesit gjyqësor. Lirimi mund të kushtëzohet me garantimin për paraqitje në procedurën gjyqësore.

4. Çdokujt që me arrestimin ose paraburgimin e tij i është privuar liria do të ketë të drejtë të ndërmarrë procedura me të cilat ligjshmëria e paraburgimit të tij do të vendoset në mënyrë të shpejtë nga ana e gjykatës dhe do të urdhërohet lirimi i tij nëse paraburgimi i tij është i paligjshëm.

5. Çdokush që ka qenë viktimë e arrestimit ose e paraburgimit në kundërshtim me dispozitat e këtij neni do të ketë të drejtë të detyrueshme për kompenzim.

## ANALIZAT

### **Vështrim i parimeve që qeverisin privimin e lirisë sipas nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

8. Së pari, Ombudspersoni përkujton se çfarëdo përcaktimi nëse privimi i lirisë i ngarkuar nga autoritetet ekzekutive është i ligjshëm në kuptim të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut varet nga përmbushja e disa kushteve. Për shembull, privimi i lirisë mund të bëhet vetëm për një rën nga arsyet e shënuara në paragrafin 1 të nenit 5 dhe mund të bëhet vetëm sipas bazave të themeluara qartë me dispozitat ligjore vendore. Përveç kësaj, çdo privim i lirisë mund të ngarkohet vetëm në pajtim me procedurat e përshkruara me ligj. Ombudspersoni më tutje përkujton se nocioni "ligjshëmi" në tërë Konventën është për t'i mbrojtur individët kundër veprimeve arbitrare të qeverisë.

[L]igjshmëria e paraburgimit sipas ligjeve vendore nuk është gjithmonë element vendimtar....

[P]araburgimi [duhet të jetë] në pajtim me qëllimin e nenit 5 (1) të Konventës, i cili është që të parandalojë privimin e lirisë së personave në mënyrë arbitrare.

(Vendimi *Baranowski kundër Polonisë*, i 28 marsit 2000).

Lidhur me nenin 5, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut për një kohë të gjatë ka konsideruar se, "Në shoqërinë demokratike e cila i është nënshkruar sundimit të së drejtës, asnjë paraburgim që është arbitrar nuk mund të konsiderohet si i "ligjshëm" (shih p.sh. Vendimin *N.C. kundër Italisë*, më 11 janar 2001, citim i Vendimit *Winterwerp kundër Holandës*, më 24 tetorit 1979).

### **Nëse privimi i lirisë i vendosur me një Urdhëresë Ekzekutive të PSSP-së mund të konsiderohet të jetë për një nga qëllimet e cekura në paragrafin 1 të nenit 5**

9. Konventa evropiane për të Drejtat e Njeriut lejon shtetin të paraburgosë individët vetëm për qëllimet e caktuara të nënvizuara në paragrafin 1 të nenit 5 (shih paragrafin 7 *supra*). Ombudspersoni përkujton të drejtën e themeluar precedentale të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila vërteton se lista e bazave për paraburgim në nenin 5 të Konventës është e plotë. Çdo zgjerim i regjistrimit të përfshirë në paragrafin 1 të nenit 5 nga autoritetet legjislative apo ekzekutive përbën shkelje të kësaj dispozite. Nocioni siq është "paraburgimi preventiv" ose pohimet e përgjithshme për brengën për "sigurinë e shtetit", "rendin publik" ose terme të ngjajshëm që paraqiten në kontekste tjera në Konventë nuk janë bazë legjitime për privimin e lirisë sipas paragrafit 1 të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (shih p.sh. Vendimin *Jecius kundër Lituanisë*, më 31 korrikut 2000).

10. Sipas informatave në dispozicion të Ombudspersonit, Urdhëresat Ekzekutive të PSSP-së janë të bazuar në baza të tilla siq është rreziku i pohuar se individi i paraburgosur paraqet pengesë për "mundësimin e ambientit të qetë dhe të sigurtë" në "sigurinë dhe rendin publik", ose arsye tjera të ngjajshme. Ombudspersoni vëren se, sipas definimit, nocioni i privimit të lirisë që është i bazuar në "rrezik" i jep një hije

preventive atij privimi të lirisë. Kur kësaj i bashkangjiten pohimet se rreziku kanoset ndaj "sigurisë publike" ose bazave tjera të jodefinuara saktësisht, është e qartë se privimi i lirisë bie jashtë kërkesave të paragrafit 1 të nenit 5.

**Nëse privimi i lirisë i vendosur me një Urdhëresë Ekzekutive të PSSP-së mund të konsiderohet të jetë për ndonjë bazë ligjore të themeluar me dispozitat ligjore venodore**

11. Ombudspersoni përkujton se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vlerëson lartë sigurinë ligjore, veçanarisht kur kemi të bëjmë me privimin e lirisë (Vendimi *Kawka kundër Polonisë*, më 9 janar 2001). Lidhur me sigurinë ligjore, Ombudspersoni përkujton se e drejta e themeluar precedentale e Gjykatës konsideron se vija kryesore e hetimit për të përcaktuar nëse privimi i lirisë është i ligjshëm është egzistimi i dispozitave të përdorshme dhe të qarta në ligjet vendore të cilat nënkuptojnë bazat themelore në bazë të së cilave ai privim i lirisë mund të imponohet. Me fjalë të tjera, individët e privuar nga liria do të ishte duhur të jenë në gjendje të konstatojnë se çfarë aktivitete ose sjellje janë të ndaluara me ligj, me qëllim që ai ose ajo në bazë të kësaj t'i përmirësojë sjelljet.

12. Ombudspersoni më tutje përkujton se edhe poqëse bazat ligjore vendore për privimin e lirisë jenë të qarta dhe të arritshme, nocioni i sigurisë ligjore poashtu përfshin një element procedural i cili duhet të përmbushet me qëllim që të përputhet me kushtet e nenit 5 (1) të Konventës:

[P]raktika e mbajtjes së personit në paraburgim...për shkak të mungesës të rregullave të qarta që qeverisin situatën e të paraburgosurit, ku personi mund të privohet nga liria për një periudhë të pacaktuar pa autorizim *gjyqësore*, nuk është në përputhje me parimet e sigurisë ligjore dhe të mbrojtjes nga arbitrariteti, të cilat janë linjat e përbashkëta të tërë Konventës dhe sundimit të së drejtës. (Vendimi *Jecius kundër Lituanisë*, më 31 korrikut 2000) (theksim i shtuar).

13. Ombudspersoni vëren se asnjë ligj që aktualisht është në fuqi në Kosovë nuk lejon privimin e lirisë të mbështetur vetëm në diskrecion të PSSP-së. Ombudspersoni më tutje vëren se edhe nëse nxirret ndonjë ligj i cili i jep fuqi autoritetit ekzekutiv për ta urdhëruar paraburgimin e personave, duke hequr ose duke kufizuar tej mase rolin e judikaturës që të ushtrojë rolin e duhur lidhur me këtë çështje, ose përndryshe duke mbrojtur arbitraritetin, një ligj i tillë nuk do të jetë në përputhje me parimet e nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

**Nëse privimi i lirisë i vendosur me një Udhëresë Ekzekutive të PSSP-së mund të konsiderohet të jetë i vendosur në pajtim me procedurat e parapara me ligj**

14. Siç është cekur më lart (shih paragrafin 8), në mënyrë që privimi mi lirisë të jetë i ligjshëm në kuptim të nenit 5 të Konventës evropiane për të drejtat e Njeriut, bazat që përkrahin privimin e lirisë duhet të gjinden në njërën nga nën – paragrafët e nenit 5(1) të Konventës dhe në mënyrë të qartë të jenë të pranishme në ligjin vendor. Megjithatë, një element shtues i ligjshmërisë, që çdo privim i lirisë të "jetë në pajtim me procedurat e parapara me ligj", është njësoj i barabartë kah rëndësia.

15. Ombudspersoni vëren se asnjë ligj vendor i aplikueshëm në Kosovë nuk parasheh asnjë procedurë në bazë të së cilës PSSP-ja mund të lëshojë një Urdhëresë Ekzekutive që të privojë dikë nga liria.

#### *Konkludimi*

16. Në bazë të konsiderimeve të mësipërme, Ombudspersoni konkludon se çdo privim i lirisë i vendosur me Urdhëresat Ekzekutive të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombëve të Bashkuara nuk mund të konsiderohet si i ligjshëm sipas paragrafit 1 të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

#### **Nevoja e kontrollit gjyqësor mbi privimet e lirisë nën nenin 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

17. Argumenti kryesor i nenit 5 të Konventës është se judikatura ushtron mbikqyrje dhe kontroll mbi privimet e lirisë. Neni 5 dikton se gjykatat, jo vetëm në kohën fillestare të paraburgimit por gjatë tërë paraburgimit, duhet të ushtrjnë vigjilencë ndaj çdo individi i cili është privuar nga liria e tij/saj. Individi i privuar nga liria jo vetëm që duhet të kërkojë ndihmë nga gjykatat për të sfiduar ligjshmërinë apo nevojën e vazhdimit të paraburgimit, por vetë gjykatat kanë një obligim që rregullisht të marrin një rol pro-aktiv dhe në intervale të duhura të shqyrtojnë çdo privim të lirisë mbi të njejtat baza, ligjshmërinë dhe nevojën e vazhdimit të privimit.

18. Së pari, Ombudspersoni përkujton se respektimi i sundimit të së drejtës kërkon ndarjen e fuqisë, një princip që është reflektuar gjithashtu edhe në paragrafin 1 të nenit 1 të Rregullorës së UNMIK-ut nr. 1999/1 mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme të Kosovës (25 korrik 1999), i cili thotë, "Të gjitha autoritetet legjislative dhe ekzekutive në Kosovë, duke përfshirë edhe *administrimin* e judikaturës, i ngarkohen UNMIK-ut dhe ushtrohen nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm." As kjo dispozitë, e asnjë dispozitë tjetër ligjore e aplikueshme në Kosovë nuk i ngarkon autoritet gjyqësor PSSP – së.

19. Ombudspersoni më tutje përkujton se mbrojtjet procedurale të caktuara janë theksuara në paragrafin 3 të nenit 5 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, i cili thotë:

Çdo i arrestuar ose i paraburgosur në pajtim me dispozitat e paragrafit 1.c. të këtij neni, do të silltet me kohë para gjykatësit ose para zyrtarëve të tjerë të autorizuar me ligj që të ushtrjnë fuqinë ligjore dhe do të ketë të drejtë për proces gjyqësor mbrenda një kohe të arsyeshme ose të lirohet në pritje të procesit gjyqësor. Lirimi mund të kushtëzohet me garantimin për paraqitje në procedurën gjyqësore.

20. Ombudspersoni përkujton se në mënyrë që kontrolli gjyqësor mbi vendimet e paraburgimit të përmbushen kërkesat e paragrafit 3 të nenit 5 të Konventës, zyrtarët gjyqësor që e ushtrjnë atë kontroll duhet të jetë kompetent që të shqyrtojnë menjëherë dhe automatikisht pikat e çështjes së paraburgimit në fjalë, duke e dëgjuar edhe të paraburgosurin edhe qeverinë para se të merret ndonjë vendim për atë çështje. Në mesin e kompetencave të atij zyrtari gjyqësor duhet të jetë edhe fuqia për të urdhëruar lirimimin e të paraburgosurit (shih p.sh. Vendimin *Aquilina kundër Maltës*, më 29 prill

1999, dhe Vendimin *Sabeour Ben Ali kundër Maltës*, më 29 qershor 2000). Lidhur me këtë, Ombudspersoni gjithashtu përkujton që nëse vendimet e paraburgimit të marra nga zyrtari gjyqësor mund të hudhen poshtë nga ndonjë autoritet tjetër, atëherë nuk përmbushen kërkesat e paragrafit 3 të nenit 5 (Vendimi *Assenov kundër Bullgarisë*, më 28 tetor 1998).

21. Ombudspersoni verën se Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm nuk mund të konsiderohet si gjykatës apo ndonjë zyrtar tjetër gjyqësor sipas paragrafit 3 të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ombudspersoni gjithashtu verën se çdo veprim i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm apo i çdo autoriteti tjetër ekzekutiv i cili shkel apo mohon një vendim të paraburgimit të marrë nga një zyrtar gjyqësor kompetent përbën shkelje *prima facie* të kësaj dispozite.

22. Përveç mbrojtjeve procedurale specifike të siguruara individëve të cilët janë privuar nga liria në rrethanat e parapara me nenin 5(1)(c), mbrojtjet e përgjithshme procedurale të cilat duhet t'u garantohen të gjithë individëve të privuar nga liria janë të parashtruara në paragrafin 4 të nenit 5:

Çdokujt që me arrestimin ose paraburgimin e tij i është privuar liria do të ketë të drejtë të ndërmarrë procedura me të cilat ligjshmëria e paraburgimit të tij do të vendoset në mënyrë të shpejtë nga ana e gjykatës dhe do të urdhërohet lirimi i tij nëse paraburgimi i tij është i paligjshëm.

23. Ombudspersoni përkujton qëndrimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, se të drejtat e garantuara nën paragrafin 4 të nenit 5 janë shkelur në rast se nuk mund të ngritet asnjë ankim gjyqësor kundër një vendimi për paraburgim të paligjshëm. Në Vendimin *Trzaska kundër Polonisë* (11 korrik 2000), Gjykata vendosi që:

Duke u mbështetur në nenin 5(4), një person i arrestuar apo i paraburgosur ka të drejtë të paraqesë procedurat për t'u shqyrtuar para një gjykate të kushteve procedurale dhe përmbajtsore të cilat janë esenciale për "ligjshmërinë" e privimit të lirisë së tij/saj sipas nenit 5 (1) (shih Vendimin *Brogan dhe të tjerët kundër Britanisë së Madhe*, më 29 nëntor 1988, seritë A nr. 154 - B, faqe 34, paragrafi. 65) ... Procedura nën nenin 5 (4) ... duhet të kenë një karakter gjyqësor dhe të sigurojnë garantime përkatëse të llojit të privimit të lirisë në fjalë. Në rastin e personit paraburgimi i të cilit bie brenda fushës së nenit 5 (1)(c), kërkohet të behët dëgjimi (shih Vendimin *Kampanis kundër Greqisë*, më 13 korrik 1995, paragrafi 47; Vendimin *Nikolova kundër Bullgarisë*, më 25 mars 1999, paragrafi 58) (paragrafi 100).

24. Ombudspersoni verën se PSSP-ja ka lëshuar një numër të Urdhëresave Ekzekutive që zgjatin periudhat e paraburgimeve pa i siguruar të paraburgosurit apo këshilltarit të tij/saj juridik informatat për bazat e vazhimit të paraburgimit, dhe pa i ofruar asnjë mundësi të paraburgosurit për të gëzuar përfitimin nga procedurat me karakter gjyqësor për të sfiduar ligjshmërinë e atij paraburgimi, siç kërkohet në paragrafin 4 të nenit 5.

#### *Konkludimi*

25. Prandaj, Ombudspersoni konkludon se mungesa e kontrollit gjyqësor mbi privimet e lirisë të vendosura nën Urdhëresat Ekzekutive të lëshuara nga Përfaqësuesi Special i

Sekretarit të Përgjithshëm të Kombëve të Bashkuara përbën shkelje të paragrafit 3 dhe 4 të nenit 5 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut.

**E drejta për kompensim e individit i cili ka qenë paligjshëm i privuar nga liria: paragrafi 5 i nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

26. Ombudspersoni përkujton që paragrafi 5 i nenit 5 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut siguron që:

Çdokush që ka qenë viktimë e arrestimit ose e paraburgimit në kundërshtim me dispozitat e këtij neni do të ketë të drejtë të detyrueshme për kompensim.

Siç është cekur më herët, bazat e lejueshme për arrestim apo paraburgim të parashtruara në paragrafin 1 të nenit 5 të Konventës përbëjnë një listë të plotë e cila nuk mund të plotësohet përmes akteve legjislative apo egzekutive apo të interpretohet nga autoritetet qeveritare (shih paragrafin 10-12, supra). Kjo do të thotë që secili që ka qenë i arrestuar apo i paraburgosur për arsye tjera nga ato që janë parashtruar në paragrafin 1 të nenit 5 duhet të ketë mundësinë për kompensim për atë arrestim apo paraburgim. Ombudspersoni më tutje përkujton që paragrafi 5 i nenit 5 të Konventës gjithashtu siguron një të drejtë të detyrueshme për kompensim për secilin individ, arrestimi apo paraburgimi i të cilit ka qenë i ndikuar apo i vazhduar në kundërshtim me mbrojtjet procedurale të garantuara me nenin 5.

27. Ombudspersoni vëren se privimet e lirisë të vendosura me Urdhëresat Ekzekutive të lëshuara nga PSSP-ja nuk janë në pajtim me kushtet e paragrafit 1, 3 dhe 4 të nenit 5 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut. Ombudspersoni më tutje vëren që individët të cilëve u janë shkelur të drejtat me zbatimin e kësaj praktikë nuk kanë të drejtë të detyrueshme për kompensim.

*Konkludimi*

28. Prandaj, Ombudspersoni konkludon se mungesa e të drejtës së detyrueshme për kompensim përbën shkelje të paragrafit 5 të nenit 5 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut.

**PËRSERITJE E KONKLUDIMEVE**

29. Ombudspersoni konkludon:

- se çdo privimi i lirisë i vendosur me Urdhëresë Ekzekutive nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombëve të Bashkuara nuk mund të konsiderohet si i ligjshëm në kuptim të paragrafit 1 të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- se mungesa e kontrollit gjyqësor mbi privimin e lirisë të vendosur sipas Urdhëresave ekzekutive lëshuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombëve të Bashkuara përbën shkelje të paragrafit 3 dhe 4 të nenit 5 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut;



- se mungesa e një të drejte së detyrueshme për kompensim përbën shkelje të paragrafit 5 të nenit 5 Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut;

Prandaj, Ombudspersoni konkludon se privimi i lirisë i vendosur me Urdhëresat Ekzekutive nuk është në pajtim me standardet e njohura ndërkombëtare.

## **REKOMANDIMET**

32. Ombudspersoni rekomandon që Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombëve të Bashkuara:

- do të duhej që menjëherë të ndërprejë praktikën e lëshimit të Urdhëresave Ekzekutive apo çfarëdo formë tjetër të udhëzimeve, dekretëve apo vendimeve ekzekutive që vendosin privimin e lirisë mbi cilindo individ në Kosovë.
- do të duhej që, jo më vonë se më 20 korrik 2001, të themelojë një ose më tepër kolegje të përbërë nga gjykatësit ndërkombëtarë për të shqyrtuar, në baza urgjente, legjitimitetin e paraburgimit të individëve të cilët momentalisht janë të privuar nga liria në bazë të urdhëresave ekzekutive apo çfarëdo formë tjetër të udhëzimeve, dekretëve apo vendimeve ekzekutive, dhe që ky shqyrtim të jetë në pajtim me kërkesat e nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
- do të duhej që, jo më vonë se më 20 korrik 2001, ta informojë Ombudspersonin për veprimet e ndërmarra si përgjigje ndaj këtyre dy Rekomandimeve, në pajtim me nenin 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë.
- do të duhej të marrë mbi vete të pajtohet me vendimet mbi paraburgim të vendosura nga ana e kolegjeve gjyqësore që janë themeluar në pajtim me këto rekomandime.
- do të duhej që, çdo herë që kjo të ndodhë, ta informojë Ombudspersonin për vendimet e marra nga kolegjet gjyqësore dhe për veprimet që PSSP-ja ka ndërmarrë për pajtueshmëri me këto vendime;
- do të duhej që, jo më vonë se më 31 gusht 2001, të shpallë një Rregullore që themelon bazën ligjore për kërkesat për kompensimin për privimin e paligjshëm të lirisë dhe për procedurat e duhura gjyqësore lidhur me to.
- do të duhej që në datën e hyrjes së saj në fuqi, ta përhapë atë përmes të gjitha kanaleve të mundshme dhe në të gjitha gjuhët që përdoren në Kosovë, në pajtim me nenin 5.2. të Rregullores së UNMIK-ut 1999/01. Në veçanti, Rregullorja do të duhej të u shpërndahet të gjithë personave të cilët momentalisht janë të privuar nga liria në bazë urdhëresave ekzekutive të lëshuara nga PSSP-ja, dhe të gjithë gjykatësve, zyrtarëve të gjyqit ose të tjerëve të cilët ushtrojnë autoritetin gjyqësor në Kosovë;

- do të duhej që, jo më vonë se më 31 gusht 2001, ta informojë Ombudspersonin për veprimet e marra si përgjegje ndaj dy Rekomandimeve, në pajtim me nenin 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë.

Marek Antoni Nowicki  
Ombudsperson